



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 05.12.2024

Nr: 44

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESES NR. 03, DATË 15.11.2024 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË  
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjet e datës 03.12.2024 dhe 05.12.2024, me pjesëmarrjen e:

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

<b>Kërkues:</b>	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
<b>Palë të interesuara:</b>	Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë Partia Aleanca Liberale e Djathtë Partia Aleanca Arbnore Kombëtare Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet Partia Aleanca Progresiste LZHK Partia Ardhmërija Shqiptare



Partia Bindja Demokratike  
Partia Fronti i Majtë  
Partia Fryma e Re Demokratike  
Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare  
Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare  
Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen  
Partia Nisma Thurje  
Partia Agrare Ambjentaliste  
Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë  
Partia Demokracia Sociale  
Partia Balli Kombëtar  
Partia Demokratike  
Partia e Gjelbër  
Partia Socialiste e Shqipërisë  
Partia e Reformave Demokratike Shqiptare  
Partia Emigracioni Shqiptar  
Partia Kombëtare Konservatore Albania  
Partia Komuniste e Shqipërisë  
Partia Konservatore  
Partia Kristian Demokrate  
Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë  
Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve  
Partia Republikane Shqiptare  
Partia Uniteti Kombëtar  
Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve  
Partia Uniteti Kombëtar  
Arif Tafani, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Belsh, i Partisë Socialiste  
Armando Subashi, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Fier, i Partisë Socialiste  
Emirjana Sako, kandidat për kryetare bashkie, Bashkia Durrës, i Partisë Socialiste

Kreshnik Hajdari, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Kuçovë, i Partisë Socialiste

Majlinda Bufi, kandidat për kryetare bashkie, Bashkia Roskovec, i Partisë Socialiste

Mariglen Disha, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Librazhd, i Partisë Socialiste

Agron Malaj, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Mat, i Partisë Socialiste

Bukurosh Maci, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Peqin, i Partisë Socialiste

Agron Loka, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Krujë, i Partisë së Lirisë

Albert Mëlyshi, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Mirditë, i Partisë së Lirisë

Ardit Cíkuli, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Sarandë, i Partisë së Lirisë

Arjan Hoxha, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Kamëz, i Partisë së Lirisë

Aurel Malko, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Divjakë, i Partisë së Lirisë

Bardh Spahia, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Shkodër, i Partisë së Lirisë

Bedri Hoxha, kandidat për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Klos, i Partisë së Lirisë

Behar Haxhiu, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Kurbin, i Partisë së Lirisë

Besnik Dushaj, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Tropojë, i Partisë së Lirisë

Dëfrim Fiku, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Bulqizë, i Partisë së Lirisë

Dorjan Lani, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Gjirokastrë, i Partisë së Lirisë

Edmond Komino, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Përmet, i Partisë së Lirisë

Elvis Hajdërlli, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Devoll, i Partisë së Lirisë

Et'Hem Lumani, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Kolonjë, i Partisë së Lirisë

Evdar Kodheli, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Fier, i Partisë së Lirisë

Fatmir Shero, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Konispol, i Partisë së Lirisë

Fisnik Qosja, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Kavajë, i Partisë së Lirisë

Hasim Çekrezi, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Gramsh, i Partisë së Lirisë

Hil Curri, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Fushë Arrëz, i Partisë së Lirisë

Hysni Sharra, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Vlorë, i Partisë së Lirisë

Igli Cara, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Durrës, i Partisë së Lirisë

Ismail Uka, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Dibër, i Partisë së Lirisë

Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Kuçovë, i Partisë së Lirisë

Luçiano Boçi, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Elbasan, i Partisë së Lirisë

Miftar Dauti, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Has, i Partisë së Lirisë

Pashk Gjoni, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Lezhë, i Partisë së Lirisë

Resmi Shanaj, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Mallakastër, i Partisë së Lirisë

Shefki Cota, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Librazhd, i Partisë së Lirisë

Shkëlqim Hoxha, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Rrogozhinë, i Partisë së Lirisë

Sofije Alushaj, kandidat për kryetare bashkie, Bashkia Patos, e Partisë së Lirisë

Zija Ismaili, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Berat, i Partisë së Lirisë

Zini Tollozhina, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Pogradec, i Partisë së Lirisë

Pjerin Ndreu, kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Lezhë, i Partisë Socialiste

- Objekt:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ referuar vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
- Bazë ligjore:** Nenet 19 pika 1 shkronja “c” dhe 21 pika 1 shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim raportet e gjetjeve të audituesve të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023. Në përfundim të procedurës administrative, Komisioneri nëpërmjet vendimit nr. 186, datë 08.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, ka konstatuar shkelje në kundërshtim me Kodin Zgjedhor nga disa subjekte.

2. Në vijim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet Kërkesës nr. 3, datë 15.11.2024 i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e masave administrative, sipas shkeljeve përkatëse për subjektet nga pika 2 deri në pikën 88 të dispozitivit, si vijon:

*“2. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.*

*3. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.*

*4. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca Liberale e Djathtë”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.*

*5. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.*

*6. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.*

*7. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.*

8. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
9. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Ardhmëria Shqiptare”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
10. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Bindja Demokratike”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
11. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Fronti i Majtë”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
12. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Fryma e Re Demokratike”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
13. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
14. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
15. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
16. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Nisma Thurje”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
17. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Agrare Ambientaliste”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
18. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
19. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Balli Kombëtar”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
20. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Demokracia Sociale”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
21. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Demokratike”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

22. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia e Gjellbër”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
23. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
24. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Emigracioni Shqiptar”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
25. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
26. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Komuniste e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
27. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Konservatore”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
28. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Kristian Demokratë”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
29. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
30. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
31. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Republikane Shqiptare”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
32. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Uniteti Kombëtar”, me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
33. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
34. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
35. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.



36. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Komuniste e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
37. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Uniteti Kombëtar”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
38. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
39. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Lëvizja Punëtorë Shqiptarë”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
40. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Konservatore”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
41. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptarë”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
42. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia e Reformave Demokratike Shqiptarë”, me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
43. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Belsh, të Partisë Socialiste, z. Arif Tafani me gjobë në vlerën 206 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
44. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Fier, të Partisë Socialiste, z. Armando Subashi me gjobë në vlerën 138 910 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
45. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidaten për kryetare bashkie, Bashkia Durrës, të Partisë Socialiste, zj. Emirjana Sako me gjobë në vlerën 75 859 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
46. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Kuçovë, të Partisë Socialiste, z. Kreshnik Hajdari me gjobë në vlerën 500 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZsë, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
47. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidaten për kryetare bashkie, Bashkia Roskovec, të Partisë Socialiste, zj. Majlinda Bufi me gjobë në vlerën 243 500 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZsë, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
48. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Librazhd, të Partisë Socialiste, z. Mariglen



*Disha me gjobë në vlerën 125 490 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZsë, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*49. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Mat, të Partisë Socialiste, z. Agron Malaj me gjobë në vlerën 80 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*50. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Peqin, të Partisë Socialiste, z. Bukurosh Maci me gjobë në vlerën 70 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*51. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Krujë, të Partia e Lirisë, z. Agron Loka me gjobë në vlerën 486 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*52. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Mirditë, të Partia e Lirisë, z. Albert Mëlyshi me gjobë në vlerën 300 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*53. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Sarandë, të Partia e Lirisë, z. Ardit Cikuli me gjobë në vlerën 259 958 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*54. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Kamëz, të Partia e Lirisë, z. Arjan Hoxha me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*55. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Divjakë, të Partia e Lirisë, z. Aurel Malko me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*56. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Shkodër, të Partia e Lirisë, z. Bardh Spahia me gjobë në vlerën 445 280 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*57. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Klos, të Partia e Lirisë, z. Bedri Hoxha me gjobë në vlerën 156 715 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*58. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Kurbin, të Partia e Lirisë, z. Behar Haxhiu me gjobë në vlerën 132 456 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*59. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Tropojë, të Partia e Lirisë, z. Besnik Dushaj me*

*gjobë në vlerën 178 758 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*60. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Bulqizë, të Partia e Lirisë, z. Dëfrim Fiku me gjobë në vlerën 192 294 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*61. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Gjirokastër, të Partia e Lirisë, z. Dorjan Lani me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*62. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Përmet, të Partia e Lirisë, z. Edmond Komino me gjobë në vlerën 198 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*63. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Devoll, të Partia e Lirisë, z. Elvis Hajdërlli me gjobë në vlerën 223 762 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*64. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Kolonjë, të Partia e Lirisë, z. Et'Hem Lumani me gjobë në vlerën 169 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*65. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Fier, të Partia e Lirisë, z. Evdar Kodheli me gjobë në vlerën 192 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*66. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Konispol, të Partia e Lirisë, z. Fatmir Shero me gjobë në vlerën 172 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*67. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Kavajë, të Partia e Lirisë, z. Fisnik Qosja me gjobë në vlerën 392 220 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*68. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Gramsh, të Partia e Lirisë, z. Hasim Çekrezi me gjobë në vlerën 107 440 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*69. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Fushë Arrëz, të Partia e Lirisë, z. Hil Curri me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*70. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Vlorë, të Partia e Lirisë, z. Hysni Sharra me*

*gjobë në vlerën 452 311 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*71. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Durrës, të Partia e Lirisë, z. Igli Cara me gjobë në vlerën 368 135 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*72. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Dibër, të Partia e Lirisë, z. Ismail Uka me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*73. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Kuçovë, të Partia e Lirisë, z. Lefter Maliqi me gjobë në vlerën 170 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*74. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Elbasan, të Partia e Lirisë, z. Luçiano Boçi me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*75. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Has, të Partia e Lirisë, z. Miftar Dauti me gjobë në vlerën 95 948 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*76. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Lezhë, të Partia e Lirisë, z. Pashk Gjoni me gjobë në vlerën 171 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*77. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Mallakastër, të Partia e Lirisë, z. Resmi Shanaj me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*78. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Librazhd, të Partia e Lirisë, z. Shefki Cota me gjobë në vlerën 118 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*79. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Rrogozhinë, të Partia e Lirisë, z. Shkëlqim Hoxha me gjobë në vlerën 316 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*80. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidaten për kryetare bashkie, Bashkia Patos, të Partia e Lirisë, zj. Sofije Alushaj me gjobë në vlerën 80 100 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.*

*81. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Berat, të Partia e Lirisë, z. Zija Ismaili me gjobë*

në vlerën 105 840 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.

82. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Pogradec, të Partia e Lirisë, z. Zini Tollozhina me gjobë në vlerën 188 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.

83. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Lezhë, të Partisë Socialiste, z. Pjerin Ndreu me gjobë në vlerën 720 000 lekë, sipas nenit 173, pika 6 të Kodit Zgjedhor.

84. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Socialiste e Shqipërisë", me gjobë në vlerën 300 000 lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

85. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Demokratike", me gjobë në vlerën 200 000 lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

86. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë", me gjobë në vlerën 100 000 lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

87. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Republikane", me gjobë në vlerën 100 000 lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

88. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Konservatore", me gjobë në vlerën 100 000 lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor".

3. Në përputhje me rregulloren "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", u hodh shorti për caktimin e relatorit dhe u caktua anëtari z. Ledio Braho si relator i shqyrtimit të kësaj çështjeje.

4. Në datën 03.12.2024 KAS-i zhvilloi seancën e parë të shqyrtimit të kërkesës së Komisionerit në prani të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së, të ngarkuar me përfaqësimin e kërkuarit dhe me pjesëmarrjen e Av. Franci Nuri, njëkohësisht në cilësinë e përfaqësuesit të posaçëm të personit të interesuar Lefter Maliqi, kandidat për kryetar të Bashkisë Kuçovë dhe përfaqësuesit të përhershëm të Partisë Demokratike dhe Av. Elena Xhina, njëkohësisht në cilësinë e përfaqësueses së posaçme të personave të interesuar Mariglen Disha, kandidat për kryetar të bashkisë Librazhd, Kreshnik Hajdari, kandidat për kryetar të bashkisë Kuçovë, Emirjana Sako, kandidate për kryetare të bashkisë Durrës, Agron Malaj, kandidat për kryetar të bashkisë Mat, Bukurosh Maci, kandidat për kryetar të bashkisë Peqin, Majlinda Bufi, kandidate për kryetare të bashkisë Roskovec dhe në cilësinë e përfaqësueses së përhershme të Partisë Socialiste të Shqipërisë, po ashtu të pranishëm personalisht ishin personat e interesuar Dëfrim Fiku, kandidat për kryetar të bashkisë Bulqizë, Igli Cara, kandidat për kryetar të bashkisë Durrës, Hyni Sharra, kandidat për kryetar të bashkisë Vlorë, Albert Mëlyshi, kandidat për kryetar të bashkisë Mirditë; Ismail Uka, kandidat për kryetar të bashkisë Dibër, Resmi Shanaj, kandidat për kryetar të bashkisë Mallakastër, Ardit Cikuli, kandidat për kryetar të bashkisë Sarandë, Edmond Komino, kandidat për kryetar të bashkisë Përmet; Partia Aleanca Demokratike, përfaqësuar nga z. Eduard Abazi; Partia Emigracioni Shqiptar, përfaqësuar nga z. Kostaq Papa, Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, përfaqësuar nga z. Gaqo Apostoli, Partia Konservatore, përfaqësuar nga z. Kujtim Gjuzi, Partia Demokracia Sociale, përfaqësuar nga z.



Skënder Nazaj, Partia Agrare Ambientaliste, përfaqësuar nga z. Thoma Mico, Partia Ardhmëria Shqiptare, përfaqësuar nga z. Ilir Arapi dhe Partia Aleanca Demokristiane, përfaqësuar nga z. Ilir Zmalaj.

5. Më datë 05.12.2024 KAS, për shkak të pamundësisë së shqyrtimit të të gjitha sanksioneve të propozuara nga Komisioneri në datën 03.12.2024, riçeli seancën për të vijuar me shqyrtimin administrativ të Kërkesës nr. 03, datë 15.11.2024 të KSHZ.

6. KAS-i, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve dhe përgjigjet e pyetjeve, mori në shqyrtim:

- Vendimin nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023
- Kërkesën nr. 03, datë 15.11.2024 të KSHZ drejtuar KAS për vendosje sanksioni administrativ;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstatoi:**

7. Referuar kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (në vijim KShZ), rezulton se pavarësisht numrit të konsiderueshëm të subjekteve për të cilat kërkohet vendosja e një sanksioni administrativ me gjobë, ato janë të ndara sipas disa tipologjive shkeljesh, më konkretisht sipas nenit 173, pika 3, fjalia e dytë e K.Zgjedhor (31 subjekte zgjedhore), sipas nenit 173, pika 3, fjalia e parë e K.Zgjedhor (10 subjekte zgjedhore), sipas nenit 173, pika 5 të K.Zgjedhor (40 subjekte zgjedhore), sipas nenit 173, pika 6 të K.Zgjedhor (1 subjekt zgjedhor) dhe sipas nenit 173, pika 8 të K.Zgjedhor (5 subjekte zgjedhore). Për këtë arsye edhe shqyrtimi administrativ i kërkesës së KShZ është zhvilluar duke u marrë parasysh analiza e secilës tipologji shkeljeje të pretenduar nga KShZ bazuar në dispozitën përkatëse dhe provat për secilin subjekt ndaj të cilit është propozuar vendosja e një sanksioni administrativ me gjobë.

8. Në lidhje me nenin 173, pika 3, fjalia e dytë të K.Zgjedhor, KShZ, ka propozuar vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë për 31 subjekte zgjedhore. Në vendimin nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023” të KShZ, pjesë e të cilit është edhe Shtojca nr. 1 “Raport mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, në lidhje me “Konstatimet lidhur me kandidatët e listave shumemërore të partive politike”, ndër të tjera pasqyrohet se:

*“1. Subjekti zgjedhor “Aleanca Liberale e Djathtë” në total ka regjistruar 1078 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 36 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 69 prej tyre.*

*2. Subjekti zgjedhor “Aleanca Arbnore Kombëtare” në total ka regjistruar 513 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 19 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.*

3. Subjekti zgjedhor “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” në total ka regjistruar 15 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raportet financiare për fushatën zgjedhore.**

4. Subjekti zgjedhor “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane” në total ka regjistruar 106 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 5 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raportet financiare për fushatën zgjedhore.**

5. Subjekti zgjedhor “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” në total ka regjistruar 356 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 15 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

6. Subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK” në total ka regjistruar 1393 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 47 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 12 prej tyre.**

7. Subjekti zgjedhor “Ardhmërija Shqiptare” në total ka regjistruar 348 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 13 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

...

9. Subjekti zgjedhor “Bindja Demokratike” në total ka regjistruar 295 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 10 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

10. Subjekti zgjedhor “Fronti i Majtë” në total ka regjistruar 14 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

11. Subjekti zgjedhor “Fryma e Re Demokratike” në total ka regjistruar 1063 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 37 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

...

14. Subjekti zgjedhor “Lëvizja Punëtore Shqiptare” në total ka regjistruar 42 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 2 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

15. Subjekti zgjedhor “Lidhja Demokristiane Shqiptare” në total ka regjistruar 22 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

16. Subjekti zgjedhor “Minoriteti Etnik Grek Për Të Ardhmen” në total ka regjistruar 98 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 4 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

17. Subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” në total ka regjistruar 255 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 8 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 112 prej tyre.**

18. Subjekti zgjedhor “Partia Agrare Ambjentaliste” në total ka regjistruar 1674 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 61 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 58 prej tyre.**



19. Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokratike e Shqipërisë” në total ka regjistruar 413 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 16 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

20. Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” në total ka regjistruar 416 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 16 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

21. Subjekti zgjedhor “Balli Kombëtar” në total ka regjistruar 721 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 24 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

22. Subjekti zgjedhor “Demokracia Sociale” në total ka regjistruar 1486 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 53 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 1369 prej tyre.**

23. Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” në total ka regjistruar 1587 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 57 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 1440 prej tyre.**

...

25. Subjekti zgjedhor “Partia e Gjelbër” në total ka regjistruar 678 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 25 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 583 prej tyre.**

26. Subjekti zgjedhor “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare” në total ka regjistruar 81 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 4 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

27. Subjekti zgjedhor “Partia Emigracioni Shqiptar” në total ka regjistruar 32 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 1 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

28. Subjekti zgjedhor “Partia Kombëtare Konservatore Albania” në total ka regjistruar 108 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 4 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 54 prej tyre.**

29. Subjekti zgjedhor “Partia Komuniste e Shqipërisë” në total ka regjistruar 76 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 3 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

30. Subjekti zgjedhor “Partia Konservatore” në total ka regjistruar 138 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 4 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

31. Subjekti zgjedhor “Partia Kristian Demokrate” në total ka regjistruar 276 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 11 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

...

33. Subjekti zgjedhor “Partia Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë” në total ka regjistruar 70 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 3 bashki. **Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.**

...

36. Subjekti zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” në total ka regjistruar 74 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 2 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore.

37. Subjekti zgjedhor “Partia Republikane Shqiptare” në total ka regjistruar 1610 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 58 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore nga 69 prej tyre.

...

40. Subjekti zgjedhor “Partia Uniteti Kombëtar” në total janë regjistruar 360 kandidat të listave shumemërore (këshillat bashkiak) për 13 bashki. Nga kandidatët e regjistruar nuk janë dorëzuar raporte financiare për fushatë zgjedhore”.

8.1. Siç rezulton nga konstatimet e mësipërme, nga këto 31 subjekte zgjedhore, 22 prej tyre<sup>1</sup> nuk kanë depozituar raporte financiare për asnjë prej kandidatëve të tyre të listave shumemërore (kandidatët për këshilla bashkiak), ndërkohë që 9 prej tyre i kanë depozituar, por jo për të gjithë kandidatët<sup>2</sup>. Po ashtu është për t'u theksuar që nga 22 subjektet zgjedhore që nuk kanë depozituar raportet financiare për kandidatët e listave shumemërore, 10 prej tyre<sup>3</sup>, nuk kanë paraqitur raportin financiar për fushatën zgjedhore në zbatim të nenit 92/3 të K.Zgjedhor dhe shkelja e tyre do të trajtohet në vijim në zbatim të fjalisë së parë të nenit 173, pika 3 të K.Zgjedhor. Mosveprimin e plotë apo të pjesshëm të subjekteve zgjedhore në lidhje me raportet financiare të kandidatëve nga listat shumemërore, KShZ e ka klasifikuar si në shkelje të nenit 173, pika 3, fjalja e dytë e K.Zgjedhor, sipas të cilit parashikohet se “Paraqitja e raporteve (financiare) në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë”. Po ashtu, në lidhje me rregullat për financimin e fushatave zgjedhore, duhen referuar edhe dy vendimmarrje të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së, më konkretisht vendimi nr. 15, datë 07.04.2024 “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” dhe vendimi nr. 20, datë 20.04.2023 “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

8.2. Në vendimin nr. 15, datë 07.04.2023 të Komisionit Rregullator përcaktohen rregullat për raportimin financiar për fushatë zgjedhore të subjekteve zgjedhore, përfshirë kandidatët e listave shumemërore, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, për

<sup>1</sup> “Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, “Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, “Partia Ardhmërija Shqiptare”, “Partia Bindja Demokratike”, “Partia Fronti i Majtë”, “Partia Fryma e Re Demokratike”, “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”, “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë”, “Partia Balli Kombëtar”, “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, “Partia Emigracioni Shqiptar”, “Partia Komuniste e Shqipërisë”, “Partia Konservatore”, “Partia Kristian Demokrate”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” dhe “Partia Uniteti Kombëtar”.

<sup>2</sup> “Partia Aleanca Liberale e Djathtë”, “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, “Partia Nisma Thurje”, “Partia Agrare Ambjentaliste”, “Partia Demokracia Sociale”, “Partia Demokratike”, “Partia e Gjellbër”, “Partia Kombëtare Konservatore Albania” dhe “Partia Republikane Shqiptare”.

<sup>3</sup> “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”, “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, “Partia Komuniste e Shqipërisë”, “Partia Konservatore”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” dhe “Partia Uniteti Kombëtar”.

monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe miratimin e modeleve të dokumentacionit që do të përdoret me këtë rast. Në nenin 2, pika 3 të këtij vendimi parashikohet se “Raporti financiar për fushatën zgjedhore për kandidatët e listave shumemërore hartohet dhe plotësohet sipas modelit KQZ 03-09, shtojca nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi”. Në nenin 8 të këtij vendimi përcaktohen përgjegjësitë e kandidatëve të listave shumemërore dhe kandidatëve për kryetar bashkie të propozuar nga partia politike/koalicioni, duke u parashikuar më konkretisht se:

*“1. Kandidati i listës shumemërore dhe kandidati për kryetar bashkie ka detyrimin të informojë në mënyrë periodike financiarin e partisë politike/financierin e partisë udhëheqëse të koalicionit për të ardhurat dhe shpenzimet e kryera prej tyre, si dhe ka detyrimin të ndjekë udhëzimet e këtij të fundit.*

*2. Kandidati i listave shumemërore, si dhe kandidati për kryetar bashkie ka detyrim të dorëzojë tek financieri brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zgjedhjeve raportin financiar të shoqëruar me dokumentet justifikuese për fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera prej tij gjatë fushatës zgjedhore.*

*3. Kandidati i listave shumemërore dhe kandidati për kryetar bashkie dokumenton dhe regjistron vlerat e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi.*

*4. Kandidati i listave shumemërore dhe kandidati për kryetar bashkie duhet të deklarojnë në momentin e regjistrimit në zgjedhje llogarinë e posaçme bankare nëse planifikon të pranojë dhurime për fushatën e tij”.*

Bashkëlidhur këtij vendimi është edhe Shtojca 2 që është miratuar nga Komisioni Rregullator së bashku me vendimin e sipërcituar – “Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” – Modeli KQZ 03-09.

8.3. Në vendimin nr. 20, datë 20.04.2023 të Komisionit Rregullator, ky i fundit, ndër të tjera sipas pikës 1, shkronja “b” të këtij vendimi ka vendosur “1. Miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike kur konkurrojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, si vijon: ... b) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e listave shumemërore, sipas modelit KQZ 07-07, shtojca nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi”. Udhëzuesi i miratuar me këtë vendim është i ndarë në dy seksione. Seksioni i parë paraqet një përmbledhje të bazës ligjore dhe kërkesave që rregullojnë financimin e fushatave zgjedhore për kandidatët e listave shumemërore, ndërsa seksioni i dytë jep udhëzime për plotësimin e formularit tip të raportimit të financimit të fushatës zgjedhore për kandidatët.

**8.4. Si fillim KAS vlerëson të argumentojë se cili është qëllimi i rregullimit të raportimit për financimin e fushatës zgjedhore të kandidatëve të listave shumemërore. K.Zgjedhor rregullon financimin e fushatave zgjedhore edhe të kandidatëve të listave shumemërore. Ky kod vendos një tavan shpenzimi për një parti politike mund të shpenzojë për qëllime të fushatës zgjedhore, shumë kjo e cila përfshin në mënyrë eksplicite edhe shpenzimet e**

kandidatëve<sup>4</sup>. Po kështu, kufizimet në burimet e lejuara të dhurimeve dhe shuma maksimale e lejuar e dhurimeve vlejné edhe për dhurimet për kandidatët.

**8.5. Nëse kandidatët nuk raportojné pranë partisë politike për shpenzimet e tyre, partitë politike nuk mund të kenë një pasqyrë të saktë të shpenzimeve të tyre të fushatës zgjedhore për qëllime të përmbushjes së kërkesës ligjore në lidhje me limitin e shpenzimeve për fushatë. Për më tepër, KQZ-ja është e ngarkuar me mbikëqyrjen e respektimit të tavanit të shpenzimeve të fushatës. Në mungesë të raportimit të shpenzimeve të kandidatëve nga partitë politike, KQZ-ja nuk do të ishte në gjendje të llogarisë shumën totale të shpenzimeve të kryera, gjë që do ta bënte tavanin e shpenzimeve ligjore praktikisht të pazbatueshëm.**

8.6. Për këtë arsye Komisioni Rregullator ka miratuar një akt nënligjor për verifikimin dhe kontrollin e raporteve të financimit të fushatës (*Vendimi nr. 15, datë 04.07.2023*). Akti nënligjor detyron kandidatët të raportojné të ardhurat dhe shpenzimet tek kryefinancieri në selinë qendrore të partisë së tyre politike apo tek kryefinancieri i partisë udhëheqëse në rastin e koalicioneve brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e zgjedhjeve, në mënyrë që informacioni të integrohet në raportin financiar që partia politike/subjekti zgjedhor paraqet në KQZ.

**8.7. Referuar qëllimit të raportimit financiar në lidhje me kandidatët e listave shumëmemërore nga subjektet zgjedhore parti politike apo koalicione, del qartë që mungesa e plotë apo e pjesshme e këtij raportimi, sjell pamundësi për verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në fushatë zgjedhore, jo vetëm për kandidatët, por edhe për vetë subjektin zgjedhor, çka e bën të pamundur transparencën në lidhje me financimin e fushatave zgjedhore.**

8.8. Për sa më sipër, pavarësisht prapësimeve të subjekteve zgjedhore që ishin të pranishme gjatë seancës së shqyrtimit administrativ të kësaj kërkesë, në lidhje me pamundësinë e tyre objektive si parti politike “të vogla” apo se numri i kandidatëve të listave shumëmemërore për të cilët nuk kishin dorëzuar raporte financiare në raport me ata të cilit kishin dorëzuar ishte irelevant, KAS vlerëson se mungesa e paraqitjes së raporteve financiare në shkelje të nenit 173 pika 3 fjalia e dytë e K.Zgjedhor nga subjektet zgjedhore, është një shkelje që e cënon në themel financimin e fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore pasi pamundëson transparencën e financimit në sytë e zgjedhësve, por edhe kontrollin e financimit nga ana e KQZ e cila e ka kompetencë funksionale këtë proces. Për atë kohë sa K.Zgjedhor dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, kanë përcaktuar qartësisht detyrimin e subjekteve zgjedhore për të depozituar raportet financiare për kandidatët e listave shumëmemërore dhe po ashtu janë miratuar edhe formatet standarde për këtë financim, atëherë gjendur në kushtet që subjektet zgjedhore “Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, “Partia Aleanca Liberale e Djathtë”, “Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, “Partia Ardhmërija Shqiptare”, “Partia Bindja Demokratike”, “Partia Fronti i Majtë”, “Partia Fryma e Re Demokratike”, “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, “Partia Nisma Thurje”, “Partia Agrare Ambjentaliste”, “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë”, “Partia Balli Kombëtar”, “Partia Demokracia Sociale”, “Partia Demokratike”, “Partia e Gjellbër”, “Partia Emigracioni Shqiptar”, “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, “Partia Kristian Demokratë” dhe “Partia Republikane Shqiptare”, i kanë depozituar raportet financiare në

<sup>4</sup> Kodi Zgjedhor parashikon që shpenzimet e përgjithshme të bëra nga një parti politike, duke përfshirë kandidatët e saj, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojnë 3 herë shumën më të lartë që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike (neni 92/2 pika 4 i K.Zgjedhor).



**shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja sa i përket listave shumëvërore, atëherë duhet të pranohet kërkesa e KShZ.**

8.9. Në lidhje me subjektet “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”, “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, “Partia Komuniste e Shqipërisë”, “Partia Konservatore”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, dhe “Partia Uniteti Kombëtar”, KAS vlerëson se duhet të rrëzohet kërkesa e KShZ për vendosjen e sanksionit administrativ më gjobë ndaj tyre në zbatim të fjalisë së dytë të nenit 173 pika 3 të K.Zgjedhor, pasi siç u parashtrua edhe nga administrata e KQZ në seancat e shqyrtimit administrativ të kësaj kërkesë, këto subjekte nuk kanë paraqitur një raport financiar për fushatën zgjedhore në zbatim të nenit 92/3 të K.Zgjedhor. Duke qenë se KShZ pikërisht për shkak të mosparaqitjes së këtij raporti, për këto subjekte zgjedhore ka propozuar sanksion administrativ në zbatim të fjalisë së parë të nenit 173, pika 3 të K.Zgjedhor, shkelje kjo që sipas KAS përthith edhe shkeljen e parashikuar nga fjalia e parë e kësaj dispozite për aq kohë sa raporti financiar nuk është depozituar asnjëherë nga këto subjekte për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e datës 23 maj 2023, atëherë nuk ka vend për të vendosur sanksion administrativ me gjobë në zbatim të nenit 173, pika 3, fjalia e dytë e K.Zgjedhor. Nëse një subjekt zgjedhor nuk e paraqit në tërësi raportin financiar për zgjedhjet, nuk mund të diskutohet më tej paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja, pasi nëse do të pranohet se i njëjti fakt konsiderohet si shkelje e dy dispozitave ligjore, atëherë do të pranohet konkurrimin e dispozitave ligjore.

8.10. Ka “konkurrin të shkeljeve” kur një person/subjekt zgjedhor shkel më shumë se një herë K.Zgjedhor dhe “konkurrin të dispozitave ligjore” kur një veprim/mosveprim që përbën shkelje administrative, duket sikur përfshihet në fushën e zbatimit të më shumë se një dispozite ligjore.

8.11. Konkurrin i dispozitave ligjore është vetëm në dukje, pasi çdo shkelje përcaktohet nga një dispozitë ligjore. Nuk është e mundur që një veprim apo mosveprim, në kuptimin e një shkeljeje administrative, të parashikohet njëkohësisht nga dy dispozita të ndryshme.

8.12. Për të zgjidhur çështjen e zbatimit të dispozitës dhe të cilësimit të saktë të shkeljes administrative, kur në pamje të parë (*prima facie*), duket sikur vepron disa dispozita ligjore, janë elaboruar parimet vijuese:

- i. parimi i specialitetit (*lex specialis derogat legi generali*);
- ii. parimi i subsidiaritetit (*lex primaria derogat legi subsidiaria*);
- iii. parimi i përthithjes (*lex consumens derogat legi consumptae*).

8.13. Në bazë të parimit të specialitetit, kur dy dispozita rregullojnë të njëjtën lëndë, zbatohet dispozita e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang dispozitën e përgjithshme. Raporti i specialitetit ekziston kur elementet përbërëse të një dispozite (të përgjithshme), janë të gjitha të pranishme edhe në një dispozitë tjetër (e posaçme), e cila përveç tyre, përmban edhe disa elemente specifike, që e cilësojnë dispozitën e dytë, në raport me të parën.

8.14. Sipas parimit të subsidiaritetit, një dispozitë kryesore ka përparësi, kur e mbron në një nivel më lartë marrëdhënien juridike, që mbrohet në një nivel më të ulët nga një dispozitë dytësore. Pra, fakti i paligjshëm i parashikuar sipas dispozitës dytësore, plotëson dhe përthithet nga fakti i paligjshëm i

parashikuar nga dispozita kryesore, duke gjetur përparësi zbatimi i dispozitës kryesore. Në këtë rast, konkurrimi i dispozitave ligjore, zgjidhet në favor të dispozitës kryesore. Vetëm në rast se, fakti i paligjshëm, nuk hyn në fushëzbatimin e dispozitës kryesore do të gjejë zbatim dispozita dytësore.

8.15 Sipas parimit të përthithjes, kur më shumë se një dispozitë i referohet një fushe të njëtrajtshme të marrëdhënies juridike, duhet të gjejë zbatim ajo dispozitë që e përfshin në mënyrë të plotë dhe shterruese kundërligjshmërinë e cënimeve, duke mbizotëruar mbi dispozitat e tjera. Kjo për arsye se, zbatimi i dispozitës më të rëndë, për të njëjtin fakt, konsumon përmbajtjen e dispozitës më të lehtë. Në raportin përthithës, dispozita përthithëse përfshin brenda vetes faktin e paligjshëm të dispozitës së konsumuar dhe zbatohet kur përmbajtja e njërës dispozitë është më e gjerë dhe në të përfshihet edhe përmbajtja e dispozitës tjetër.

**8.16 Ndaj, referuar parimeve të sipërcituara, në rastin kur një subjekt zgjedhor dështon të dorëzojë raportin financiar të fushatës zgjedhore në tërësi në zbatim të nenit 92/3 të K.Zgjedhor, fjalia e parë e nenit 173, pika 3 të K.Zgjedhor, përthith edhe shkeljen e parashikuar nga fjalia e dytë e kësaj pike. I vetmi rast kur këto dy dispozita do të aplikoheshin njëkohësisht ndaj një subjekti zgjedhor, do të ishte kur raporti financiar për fushatën zgjedhore paraqitet në KQZ tej afatit të parashikuar nga K.Zgjedhor si dhe pavarësisht këtij fakti paraqitet edhe në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja**

8.17. Në lidhje me vlerën e gjobës e cila është propozuar në masën prej 500,000 lekë për secilin prej subjekteve zgjedhore, KAS vlerëson se në lidhje me këtë element do i referohet neneve 10 dhe 18 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Neni 10 i këtij ligji, në pikat 1 dhe 2 të tij parashikon se:

*“1. Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë.*

*2. Në rastet kur ligji i posaçëm vendos kufij minimalë dhe maksimalë për vlerën e dënimit me gjobë, atëherë, për qëllim të marrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, organi administrativ kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes, përveç parimeve të parashikuara nga neni 18 i këtij ligji, miraton edhe metodikën apo parime të tjera shtesë, mbi të cilat mbështetet për përcaktimin e vlerës së gjobës, për rastet e kundërvajtjeve, për të cilat parashikohet i njëjti dënim”*

ndërkohë që neni 18 i po këtij ligji parashikon se:

*“Në përzgjedhjen e llojit të dënimit dhe në caktimin e masës së tij, në rastet kur ligji ka parashikuar kufij minimalë e maksimalë të vlerës së gjobës, organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh:*

*a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;*

*b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;*

*c) rëndësinë e kundërvajtjes;*

*ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi”.*

**8.18. Duke qenë se dispozita që parashikon sanksionin administrativ me gjobë parashikon kufij minimalë dhe maksimale dhe në mungesë të një metode të miratuar për përcaktimin e**



vlerës së gjobës, KAS vlerëson se dënimi me gjobë në kufirin minimal për subjektet zgjedhore për të cilat u pranua kërkesa e KShZ për vendosjen e sanksionit administrativ është në përputhje me nenin 18 të sipërcituar pasi së pari këto rregulla janë miratuar për herë të parë për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 dhe për rrjedhojë këto subjekte zgjedhore nuk janë dënuar më parë për këtë shkelje. Së dyti, KAS merr parasysh që vlera e gjobës mos te jetë e tillë që të çenojë pjesëmarrjen në zgjedhjet e radhës për këto parti politike për aq kohë sa bëhet fjalë për një numër të konsiderueshëm partish politike që kanë ndikim në pluralizmin zgjedhor, pavarësisht peshës zgjedhore të ndryshme që ato kanë në raport me njëra tjetrën.

9. Në lidhje me nenin 173, pika 3, fjalia e parë të K.Zgjedhor, KShZ, ka propozuar vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë për 10 subjekte zgjedhore. Në vendimin nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023” të KShZ, pjesë e të cilit është edhe Shtojca nr. 1 “Raport mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, në lidhje me “Raportet financiare të padorëzuara”, ndër të tjera pasqyrohet se:

*“Nga shqyrtimi i raporteve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se 11 (njëmbëdhjetë) subjekte zgjedhore nuk e kanë dorëzuar raportin financiar në përputhje me nenin 92/3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin nr. 15, datë 7.4.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore”, si dhe Vendimin nr. 458, datë 6.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për raportimin financiar në platformën elektronike të raportimin financiar (PERF) nga subjektet zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023”, si më poshtë vijon:*

- 1. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve (P.M.D.E);*
- 2. Aleanca Arbnore Kombëtare (AAK);*
- 3. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë (P.M.D.P.SH);*
- 4. Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH);*
- 5. Partia Uniteti Kombëtar (PUK);*
- 6. Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE);*
- 7. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare (P.L.P.SH);*
- 8. Partia Konservatore (KONS);*
- 9. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ);*
- 10. Lidhja Demokristiane Shqiptare (L.D.K);*
- 11. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare (P.R.D.Sh)”.*

9.1. Në lidhje me detyrimin e subjekteve zgjedhore për deklarimin dhe publikimin e raportit financiar për fushatën zgjedhore, do i referohemi nenit 92/3 të K.Zgjedhor që parashikon se:

*“1. Subjektet zgjedhore janë të detyruara të paraqesin raport financiar për fushatën zgjedhore në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve.*

2. Raportet financiare hartohen sipas modeleve të miratuara nga KQZ-ja. Raporti, si rregull, duhet të përmbajë informacion, për:

a) çdo dhurim, hua ose kredi që i është dhënë subjektit zgjedhor (duke përfshirë edhe degët dhe kandidatët e tij) gjatë fushatës zgjedhore dhe gjashtë muaj para fushatës dhe burimin e tij, përfshirë edhe dhurimet apo shërbimet në natyrë;

b) të ardhurat për qëllime të fushatës zgjedhore nga të gjitha burimet e tjera të lejuara;

c) të gjithë zërat e shpenzimeve për qëllime të fushatës zgjedhore siç përcaktohen në vendimin e KQZ-së dhe në pikën 4 të nenit 92/2 të këtij ligji;

ç) bilancin e aseteve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve.

3. Çdo parti politike që merr pjesë në zgjedhje mban dhe ruan në arkiv për një periudhë prej 7 vjetësh dokumentacionin e plotë dhe të hollësishëm të statusit të saj financiar dhe të degëve të saj për periudhën që mbulon ky raport, duke përfshirë:

a) librat e llogarive/kontabilitetit, mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku pasqyrohen të gjitha të ardhurat sipas burimit dhe shumës, identifikohet si është bërë pagesa, si dhe pagesat e bëra personave të tretë, qëllimet e pagesave dhe se si është kryer çdo pagesë;

b) dokumentacionin e të gjitha shpenzimeve të bëra;

c) situatën dhe lëvizjet në llogarinë e saj bankare;

ç) dokumentacionin e plotë të pronave të paluajtshme që zotëron partia politike, si dhe çdo kontratë të lidhur për marrje me qira, dhënie me qira, porositje apo shitje të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme;

d) regjistrin e dhuruesve, huadhënësve dhe kredidhënësve, sipas modelit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 92/2”.

**9.2. Në kushtet kur subjektet zgjedhore për të cilat KShZ ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në zbatim të nenit 173, pika 3, fjalia e parë të K.Zgjedhor<sup>5</sup>, nuk e kanë respektuar këtë detyrim të rëndësishëm të parashikuar nga neni 92/3 i K.Zgjedhor në lidhje me rregullat për financimin e fushatës zgjedhore, atëherë ato duhet të ngarkohen me përgjegjësi administrative.**

9.3. Për sa më sipër, KAS vlerëson të pranojë kërkesën e KShZ për vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në masën 2,000,000 lekë në zbatim të nenit 173, pika 3, fjalia e parë të K.Zgjedhor për subjektet zgjedhore “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”, “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, “Partia Komuniste e Shqipërisë”, “Partia Konservatore”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” dhe “Partia Uniteti Kombëtar”.

10. Në lidhje me nenin 173, pika 5, fjalia e parë të K.Zgjedhor, KShZ ka propozuar vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë për 40 subjekte zgjedhore të cilët kanë qenë kandidatë për kryetar bashkie për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në vendimin nr. 186,

<sup>5</sup> “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”, “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, “Partia Komuniste e Shqipërisë”, “Partia Konservatore”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” dhe “Partia Uniteti Kombëtar”.

datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023” të KShZ, pjesë e të cilit është edhe Shtojca nr. 1 “Raport mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, në lidhje me “Konstatimet lidhur me kandidatët për kryetar bashkie të partive politike”, ndër të tjera pasqyrohet se:

*“Kandidatët për kryetar bashkie të Partisë Socialiste të cilët kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogari bankare janë si më poshtë vijon:*

- 1. Z. Arfi Tafani, bashkia Belsh, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 206 000 lekë;*
- 2. Z. Armando Subashi, bashkia Fier, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 138 910 lekë;*
- 3. Zj. Emirjana Sako, bashkia Durrës, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 75 859 lekë;*
- 4. Z. Kreshnik Hajdari, bashkia Kuçovë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 500 000 lekë;*
- 5. Zj. Majlinda Bufi, bashkia Roskovec, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 243 500 lekë;*
- 6. Z. Mariglen Disha, bashkia Librazhd, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 125 490 lekë;*
- 7. Z. Agron Malaj, bashkia Mat, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 80 000 lekë;*
- 8. Z. Bukurosh Maci, bashkia Peqin, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 70 000 lekë.*

*Kandidatët për kryetar bashkie të Partisë së Lirisë të cilët kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogari bankare janë si më poshtë vijon:*

- 1. Z. Agron Loka, bashkia Krujë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 486 000 lekë;*
- 2. Z. Albert Mëlyshi, bashkia Mirditë, ka pranuar fonde cash në vlerën 300 000 lekë;*
- 3. Z. Ardit Cikuli, bashkia Sarandë, ka pranuar fonde cash në vlerën 259 958 lekë;*
- 4. Z. Arjan Hoxha, bashkia Kamëz, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;*
- 5. Z. Aurel Malko, bashkia Divjakë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;*
- 6. Z. Bardh Spahia, bashkia Shkodër, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 445 280 lekë;*
- 7. Z. Bedri Hoxha, bashki Klos, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 156 715 lekë;*
- 8. Z. Behar Haxhiu, bashkia Kurbin, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 132 456 lekë;*
- 9. Z. Besnik Dushaj, bashkia Tropojë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 178 758 lekë;*
- 10. Z. Dëfrim Fiku, bashkia Bulqizë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 192 294 lekë;*
- 11. Z. Dorjan Lani, bashkia Gjirokastër, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;*
- 12. Z. Edmond Komino, bashkia Përmet, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 198 000 lekë;*
- 13. Z. Elvis Hajdërlli, bashkia Devoll, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 223 762 lekë;*
- 14. Z. Et’Hem Lumani, bashkia Kolonjë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 169 000 lekë;*
- 15. Z. Evdar Kodheli, bashkia Fier, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 192 000 lekë;*

16. Z. Fatmir Shero, bashkia Konispol, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 172 000 lekë;
17. Z. Fisnik Qosja, bashkia Kavajë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 392 220 lekë;
18. Z. Hasim Cekrezi, bashkia Gramsh, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 107 440 lekë;
19. Z. Hil Curri, bashkia Fushë Arrëz, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
20. Z. Hysni Sharra, bashkia Vlorë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 452 311 lekë;
21. Z. Iglë Cara, bashkia Durrëz, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 368 135 lekë;
22. Z. Ismail Uka, bashkia Dibër, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
23. Z. Lefter Maliqi, bashkia Kuçovë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 170 000 lekë;
24. Z. Luçiano Boçi, bashkia Elbasan, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
25. Z. Miftar Dauti, bashkia Has, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 95 948 lekë;
26. Z. Pashk Gjoni, bashkia Lezhë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 171 100 lekë;
27. Z. Resmi Shanaj, bashkia Mallakastër, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 72 000 lekë;
28. Z. Shefki Cota, bashkia Librazhd, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 118 000 lekë;
29. Z. Shkëlqim Hoxha, bashkia Rrogozhinë, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 316 000 lekë;
30. Zj. Sofije Alushaj, bashkia Patos, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 80 100 lekë;
31. Z. Zija Ismaili, bashkia Berat, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 105 840 lekë;
32. Z. Zini Tollozhina, bashkia Pogradec, i ka dhuruar vetes cash fonde në vlerën 188 000 lekë”.

10.1. Nisur nga këto konstatime, KShZ, nëpërmjet kërkesës objekt i këtij shqyrtimi administrativ, bazuar në nenin 173, pika 5 të K.Zgjedhor që parashikon se “Pranimi i fondeve private më vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së”, i ka kërkuar KAS që të sanksionojë me gjobë sipas vlerave përkatëse të konstatuara si të kaluara jo nëpërmjet llogarisë së posaçme secilin prej kandidatëve për kryetar bashkie të sipërcituar.

10.2. Në lidhje me këtë tipologji të pretenduar shkeljeje të kërkuar për t’u sanksionuar nga ana e KShZ, KAS vlerëson të analizojë si fillim bazën ligjore përkatëse.

Neni 92/1 pikat 1, 2 dhe 5 të K.Zgjedhor parashikojnë se:

“1. Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre mund të marrin fonde për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij ligji, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlera në sende ose shërbime. Vlera e shumës sipas fjalisë së parë të kësaj pike, indekskohet nga KQZja çdo pesë vjet sipas normës së inflacionit.

...

5. Subjekti zgjedhor është i detyruar të bëjë publike dhe të sigurojë akses të plotë e të pandërprerë të të tretëve në bazën e të dhënave, ku subjekti zgjedhor regjistron dhurimet, huat ose kreditë e përfituara nga ai dhe kandidatët e tij, për të gjitha vlerat e barabarta dhe



*më të larta se 50 mijë lekë”.*

Neni 92/2 pikat 1, 2 dhe 3 të K.Zgjedhor parashikojnë se:

*“1. Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 92/1 të këtij ligji dhe mban përgjegjësi personale për deklarim të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t’u nënshkruar në çdo rast dhurimi.*

*2. Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në llogari të posaçme të hapura në banka nga subjekti zgjedhor. Llogaritë deklarohen në momentin e regjistrimit sipas nenit 64 të këtij ligji. Në formularin e deklarimit përfshihet edhe autorizimi për KQZ-në dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë. Subjekti zgjedhor nuk mund të përdorë asnjë llogari tjetër bankare, përveç atyre të deklaruara, për pranimin e dhurimeve për fushatën zgjedhore, qoftë edhe për shuma më të vogla se 50 mijë lekë.*

*3. Kandidatët e subjekteve zgjedhore, nëse planifikojnë të pranojnë dhurime për fushatën e tyre me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë, janë të detyruar të hapin llogari bankare të posaçme për të pranuar dhurimin e fondeve jopublike. Llogaritë deklarohen në momentin e regjistrimit sipas nenit 67 të këtij ligji. Në formularin e deklarimit përfshihet edhe autorizimi për KQZ-në dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë. Kandidati i subjektit zgjedhor nuk mund të përdorë asnjë llogari tjetër bankare, përveç atyre të deklaruara, për pranimin e dhurimeve për fushatën zgjedhore, qoftë edhe për shuma më të vogla se 50 mijë lekë”.*

10.3. Në vendimin nr. 15, datë 07.04.2023 të Komisionit Rregullator përcaktohen rregullat për raportimin financiar për fushatë zgjedhore të subjekteve zgjedhore, përfshirë kandidatët e listave shumemërore, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe miratimin e modeleve të dokumentacionit që do të përdoret me këtë rast. Në nenin 2, pika 4 të këtij vendimi parashikohet se *“Raporti financiar për fushatën zgjedhore për kandidatët për kryetar bashkie hartohet dhe plotësohet sipas modelit KQZ 03-10, shtojca nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi.”.* Në nenin 8 të këtij vendimi përcaktohen përgjegjësitë e kandidatëve të listave shumemërore dhe kandidatëve për kryetar bashkie të propozuar nga partia politike/koalicioni, duke u parashikuar më konkretisht se:

*“1. Kandidati i listës shumemërore dhe kandidati për kryetar bashkie ka detyrimin të informojë në mënyrë periodike financiarin e partisë politike/financierin e partisë udhëheqëse të koalicionit për të ardhurat dhe shpenzimet e kryera prej tyre, si dhe ka detyrimin të ndjekë udhëzimet e këtij të fundit.*

*2. Kandidati i listave shumemërore, si dhe kandidati për kryetar bashkie ka detyrim të dorëzojë tek financieri brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zgjedhjeve raportin financiar të shoqëruar me dokumentet justifikuese për fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera prej tij gjatë fushatës zgjedhore.*

*3. Kandidati i listave shumemërore dhe kandidati për kryetar bashkie dokumenton dhe regjistron vlerat e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të*

tjera që lidhen me identifikimin e dhuruesit, huadhënësit ose kredithënësit sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Kandidati i listave shumemërore dhe kandidati për kryetar bashkie duhet të deklarojnë në momentin e regjistrimit në zgjedhje llogarinë e posaçme bankare nëse planifikon të pranojë dhurime për fushatën e tij”.

10.4. Bashkëlidhur këtij vendimi është edhe Shtojca 3 që është miratuar nga Komisioni Rregullator së bashku me vendimin e sipërcituar – “*Formati tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për kandidatët për kryetarë bashkie të organeve të qeverisjes*” – Modeli KQZ 03-10.

10.5. Në këtë format tip, në Seksionin 1 (Përmbledhje financiare) përcaktohet se totali i të ardhurave përbëhet nga a. Totali i të ardhurave nga persona fizikë dhe b. Totali i të ardhurave nga persona juridikë, pra mungon vetëfinancimi si mënyrë financimi i fushatës nga kandidati për kryetar bashkie. Po ashtu, në seksionet 2.a dhe 2.b janë detajuar disa elementë të dhuruesit si statusi, emër, mbiemër etj..

10.6. Në vendimin nr. 20, datë 20.04.2023 të Komisionit Rregullator, ky i fundit, ndër të tjera sipas pikës 1 shkronja “c” të këtij vendimi ka vendosur “1. Miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike kur konkurrojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, si vijon: ... c) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët për kryetar bashkie, sipas modelit KQZ 07-08, shtojca nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi”. Udhëzuesi i miratuar me këtë vendim është i ndarë në dy seksione. Seksioni i parë paraqet një përmbledhje të bazës ligjore dhe kërkesave që rregullojnë financimin e fushatave zgjedhore për kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, ndërsa seksioni i dytë jep udhëzime për plotësimin e formularit tip të raportimit të financimit të fushatës zgjedhore për kandidatët.

10.7. Në këtë udhëzim, në lidhje me kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, ndër të tjera është udhëzuar se:

*“Cilat janë burimet që lejohen për financimin e fushatës zgjedhore për kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore?”*

*Burimet e financimit të fushatës zgjedhore për kandidatët janë:*

- Dhurimet nga burime jo-publike (private);
- Financimi nga burime vetjake të kandidatit;
- Mbështetja financiare nga partia/subjekti<sup>3</sup>;
- Huatë ose kreditë<sup>6</sup>.

*Ligji përcakton kushtet dhe kufizimet për çdo burim financimi, siç trajtohen më poshtë:*

#### *1. Dhurimet nga individë privatë*

*Për qëllime të financimit të fushatës zgjedhore, kandidatët mund të marrin fonde vetëm nga personat fizikë ose juridikë vendas<sup>7</sup>. Fjala “vendas” në ligj është përdorur si antonim i fjalës “i huaj”, pra ka lidhje me shtetësinë e personit dhe jo me vendbanimin e tij. Prandaj termi*

<sup>6</sup> Shiko nenin 86, pika ç, të Kodit Zgjedhor

<sup>7</sup> “Person juridik” është termi i përdorur nga ligji i cili nënkupton subjektet juridike.



“person fizik vendas” përfshin edhe shtetas shqiptarë që jetojnë në një vend tjetër<sup>8</sup>. Kjo do të thotë që personat fizikë dhe juridikë të huaj nuk lejohen të dhurojnë për fushatën e kandidatit.

...

Shuma totale që mund të kontribuojë çdo donator është e kufizuar në 1 milion lekë (qoftë në para ose në vlerën ekuivalente të një donacioni në natyrë). Çdo dhurim mbi 1 milion lekë është i paligjshëm<sup>9</sup>. Është e rëndësishme të theksohet se kufiri prej 1 milion lekë është shuma totale që një parti/subjekt mund të marrë nga një donator i vetëm qoftë drejtpërdrejt ose qoftë nëpërmjet kandidatëve të saj.

Çdo dhurim monetar mbi 50,000 lekë duhet të derdhet në një llogari të posaçme bankare të hapur për këtë qëllim. Nëse kandidatët nuk kanë hapur llogarinë e posaçme në momentin e regjistrimit, atëherë, nga momenti i hapjes së llogarisë së posaçme për pranimin e dhurimeve, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e zgjedhjeve, duhet ta deklarojnë atë menjëherë në KQZ. Çdo donacion më i vogël që dërgohet me transfertë bankare, qoftë edhe më i vogël se 50,000 lekë, duhet gjithashtu të dërgohet në llogarinë bankare të posaçme.

#### **1. Financimi nga burime vetjake të kandidatit**

**Detyrimet e kandidatit, për vetëfinancimin e fushatës së tij, do të zbatohen të njëjtat me ato referuar nenit 92/1 pika 2 e ligjit 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.**

...

#### **4. Rregullat e tjera që rregullojnë donacionet**

*Ka rregulla të tjera që rregullojnë financimin privat të fushatave zgjedhore:*

□ Çdo dhurues duhet të nënshkruajë një deklaratë, të miratuar nga Komisioni Rregullator i KQZ-së, duke pohuar se nuk aplikohet asnjë nga kushtet e përjashtimit të dhuruesit nga dhurimi<sup>10</sup>.

*Donacionet nga donatorët anonimë janë të ndaluara<sup>9</sup>.*

*Të gjitha donacionet mbi 50,000 lekë duhet të dhurohen përmes një llogarie të posaçme bankare të deklaruar në KQZ<sup>10</sup>.*

*Emri i personave që dhurojnë shuma më të mëdha se 50,000 lekë, si dhe vlera përkatëse bëhet publik bashkë me raportin e subjektit zgjedhor<sup>11</sup>.*”

10.8. Pavarësisht se në udhëzues ka një numër të konsiderueshëm shembujsh, nuk ka asnjë shembull në lidhje me vetëfinancimin e fushatës nga ana e kandidatëve për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore.

10.9. Duke qenë se si K.Zgjedhor, ashtu edhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij nuk bëjnë një dallim mes dhurimeve nga palët e treta (persona fizikë apo juridikë) dhe vetëfinancimit të fushatës zgjedhore nga vetë kandidati për kryetar bashkie, është e domosdoshme që KAS t’i interpretojë këto dispozita në mënyrë që t’i japë kuptimin e duhur këtyre dy instituteve të rëndësishme të financimit të fushatës zgjedhore.

<sup>8</sup> Shiko nenin 92/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

<sup>9</sup> Shiko nenin 23/1, pika 3 Ligjit për Partitë Politike

<sup>10</sup> Shiko nenin 9/2, pika 3 e Kodit Zgjedhor.

<sup>11</sup> Shiko nenin 92/6, pika 1 dhe 4 e Kodit Zgjedhor.

10.10. Së pari duhet sqaruar koncepti që për vetëfinancimin nuk mund të përdoret termi “i ka dhuruar vetës” për aq kohë sa dhurimi është veprim juridik i përkufizuar në K.Civil, më konkretisht në nenet 761 e vijues të tij. Pikërisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se “Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon”. Nga interpretimi literal dhe qëllimor i saj del qartë që dhurimi kërkon me doemos dy palë të ndryshme, dhuruesin dhe pranuesin e dhurimit, që në rastin e fushatave zgjedhore pranues i dhurimit është subjekti zgjedhor, qoftë ky parti politike/koalicion apo kandidat për kryetar bashkie. Referuar këtij interpretimi, në rastin e financimit të fushatës me fonde vetjake të kandidatit për kryetar bashkie kurrsesi që nuk mund të kemi dhurim, por vetëfinancim që duhet konsideruar veprim i posaçëm dhe që për aq kohë sa nuk ndalohet nga K.Zgjedhor, do të thotë që lejohet. Ajo që duhet sqaruar në rastin e vetëfinancimit nga ana e kandidatëve është se cilat janë rregullat që duhet të zbatohen nga ana e tyre në mënyrë që mos çenohen kufizimet e përcaktuara nga K.Zgjedhor për financimin e fushatës zgjedhore, kryesisht në raport me kufirin maksimal të parashikuar për subjektin zgjedhor.

10.11. Së dyti, klasifikimi i kandidatit si vetëfinancues duket sikur sjell automatikisht pasojë që mbi kandidatin duhet të veprojë tavanin e financimit 1 milion lekë, aq sa ç’është për personat fizikë dhe juridikë si palë të treta. KAS çmon se një tavan i tillë mungon në dispozitat e K.Zgjedhor për vetëfinancimin e kandidatëve, siç mungon edhe për vetëfinancimin nga subjekti zgjedhor parti politike që nuk e ka të kufizuar vlerën që përdor nga buxheti i saj përveçse vlerës maksimale ku përfshihen dhe dhurimet, vlerë kjo që nuk mund të tejkalojë kufizimin e vendosur në nenin 92/2, pika 4 të K.Zgjedhor. Gjithsesi, vetëfinancimi duhet të jetë zë në vete në pasqyrat financiare të fushatës dhe të përmbledhë shumën e përgjithshme që kandidati derdh në llogarinë e posaçme të fushatës.

10.12. Së treti, duke qenë se në ndryshim nga neni 92/1, pika 2 e K.Zgjedhor që përdor termin “jap”, në nenin 92/2, pikat 2 dhe 3 të K.Zgjedhor përdoret termi “dhurim”, KAS vlerëson të interpretojë nëse i njëjti kufizim që parashikohet nga K.Zgjedhor për dhurimet mbi 50 mijë lekë (vetëm nëpërmjet llogarisë së posaçme bankare) duhet të zbatohet edhe për vetëfinancimin, duke qenë se ky i fundit mund të bëhet herë pas here nga vetë kandidati në varësi të dinamikës së fushatës zgjedhore.

10.13. Në lidhje me këtë çështje KAS vlerëson se së pari udhëzuesi i miratuar me vendimin nr. 20, datë 20.04.2023 të Komisionit Rregullator, në lidhje me vetëfinancimin e fushatës zgjedhore, edhe pse pa një tavan të tillë të vendosur nga K.Zgjedhor specifikisht për vetëfinancimin, i ka udhëzuar kandidatët për kryetarë bashkie se “Detyrimet e kandidatit, për vetëfinancimin e fushatës së tij, do të zbatohen të njëjtat me ato referuar nenit 92/1 pika 2 e ligjit 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, ndërkohë që nuk i ka udhëzuar në lidhje me zbatimin e nenit 92/2 pikat 2 dhe 3 të K.Zgjedhor, çka e ka bërë të paqartë për ta nëse vetëfinancimi kufizohet proceduralisht sa i përket këtij aspekti. Së dyti, është me vend për t’u kuptuar se dhurimi nga personat e tretë nuk ka të bëjë me dinamikën e fushatës zgjedhore, por vetëm me vullnetin e dhuruesit për dhurim monetar apo dhurim në natyrë. Dhurimi nga personat e tretë, duke qenë një veprim juridik i paramenduar dhe duke qenë se K.Zgjedhor ka parashikuar edhe raste të ndalimit të dhurimit (neni 92/1 pika 3) apo pasoja të posaçme për dhuruesit (neni 92/1 pika 4) është i domosdoshëm që të formalizohet paraprakisht dhe të kanalizohet nëpërmjet llogarisë së posaçme.

10.14. Ndërkohë që vetëfinancimi nga ana e vetë kandidatëve për kryetar bashkie, duhet parë në raport me dinamikën e fushatës, me shpenzimet e kryera nga ana e tyre, me mundësinë e kandidatëve që në raport me përditshmërinë e fushatës zgjedhore, çdo shpenzim të posaçëm

**që kryejnë nga fondet e tyre ta transferojnë ose depozitojnë në llogarinë e posaçme paraprakisht dhe më tej po nëpërmjet kësaj llogarie bankare të kryejnë edhe shpenzimet përkatëse.**

10.15. Gjatë seancës së shqyrtimit administrativ të kësaj kërkesë, nga një pjesë e kandidatëve për kryetar bashkie që ishin në cilësinë e palës së interesuar, u prapësua se fondet e vetëfinancuara ishin përdorur për të paguar sponsorizimet në rrjete sociale, pagesa këto që mund të bëhen vetëm elektronikisht, por duke qenë se për llogarinë e posaçme nuk mund të pajisen me kartë kreditit/debiti, është e pamundur që këto transaksione të bëhen nëpërmjet kësaj llogarie. Në këto kushte, në mënyrë që këto pagesa të bëhen nga llogaria e posaçme, një proces i tillë duhet të përfshijë një numër të konsiderueshëm transaksionesh (nga llogaria e kandidatit në favor të llogarisë së posaçme e më tej sërish nga llogaria e posaçme te llogaria e kandidatit në mënyrë që ky i fundit të bëjë pagesat për sponsorizimet në rrjete sociale) ose duhet të bëhet me nënkontraktim ku kandidati është i detyruar të lidhë kontratë shërbimi me një shoqëri tregtare që ofron shërbimin menaxhimit të rrjeteve sociale, element ky që do ta shtrenjtonte fushatën zgjedhore të një kandidati për kryetar bashkie. Një pjesë tjetër e palëve të interesuara prapësuan se këto të fonde të vetëfinancuara nga ana e tyre, pavarësisht se në total ishin në vlerën mbi 50 mijë lekë, ishin përdorur në disa pagesa me vlerë më të vogël se 50 mijë lekë gjatë përditshmërisë së fushatës dhe sipas tyre këto pagesa kanë qenë të pamundura për t'u kryer nëpërmjet transaksioneve bankare sepse janë në vlera shumë të vogla dhe që lindin si detyrime aty për aty. Po ashtu, gjatë shqyrtimit administrativ në KAS u provua qartë se kandidatët kanë referuar si “vetëfinancim” transaksionet e kryera me para në dore, në shumicën dërmuese të rasteve kanë përmbledhur disa blerje në një raportim të vetëm. Perceptimi i audituesve, se bëhej fjalë për transaksione unike në vlerë më të madhe se sa 50 mijë lekë, për pasojë të kryera në kundërshtim me rregullat për donacionet, nuk gjen mbështetje në rrethanat e faktit sipas kërkesës së KShZ, ose së paku nuk është hetuar mjaftueshëm për të provuar shkeljen e pretenduar.

**10.16. Referuar këtyre situatave të prapësuar nga palët e interesuara, kandidatë për kryetarë bashkie, për KAS nuk krijohet bindja se së pari në lidhje me vetëfinancimin nga ana e kandidatëve duhet të zbatohet rregulli i parashikuar në nenin 92/2, pikat 2 dhe 3 të K.Zgjedhor për dhurimet mbi 50 mijë lekë (vetëm nëpërmjet llogarisë së posaçme bankare) në çdo rast. Ky rregull vlen për vetëfinancimin vetëm për ato raste kur vlera monetare e vetëfinancuar është mbi 50 mijë lekë dhe është përdorur nga kandidati për një pagesë të vetme. Nëse vlera e vetëfinancuar është mbi 50 mijë lekë dhe është përdorur për më shumë se një pagesë dhe vlera e secilës prej tyre është nën 50 mijë lekë, atëherë nuk jemi në kushtet që ajo duhet të kryhet me doemos nëpërmjet llogarisë së posaçme, pasi vendosja e kandidatit në kushte kaq formale për vlera nën 50 mijë lekë, përveçse sjell mbirregullim të procedurës së vetëfinancimit, por e bën atë pothuajse të pazbatueshme në përditshmërinë e fushatës zgjedhore për dinamikën që ajo ka. Në këtë përfundim arrihet dhe nga analiza e K.Zgjedhor në lidhje me hapjen e llogarisë së posaçme nga kandidatët, llogari kjo që është e detyrueshme vetëm nëse kandidati parashikon të pranojë dhurime mbi 50 mijë lekë, çka do të thotë se për dhurime nën këtë vlerë, ato mund të pranohen edhe *cash*, për rrjedhojë ky rregull nuk mund të jetë më strikt për vetëfinancimin se sa për dhurimin.**

10.17. Si përfundim, referuar analizës së mësipërme, KAS vlerëson se kërkesa e KShZ për vendosjen e dënimit me gjobë sipas vlerave përkatëse të konstatuara si të kaluara jo nëpërmjet llogarisë së posaçme për secilin prej kandidatëve për kryetar bashkie, bazuar në nenin 173, pika 5 të K.Zgjedhor, duhet t'i kthehet KShZ për hetim administrativ më të thelluar në mënyrë që të qartësohet nëse vlera e vetëfinancuar nga kandidatët për kryetarë bashkie është përdorur për një pagesë të vetme mbi 50 mijë lekë apo është përdorur për disa pagesa nën 50 mijë lekë secila.

11. Në lidhje me nenin 173, pika 6 të K.Zgjedhor, KShZ, ka propozuar vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën 720 000 lekë për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Lezhë, të Partisë Socialiste, z. Pjerin Ndreu për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në vendimin nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023” të KShZ, pjesë e të cilit është edhe Shtojca nr. 1 “Raport mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, në lidhje me “Auditimin për subjektet zgjedhore të cilat dorëzuan raport financiar për fushatën zgjedhore 2023 dhe gjetjet përkatëse”, ndër të tjera pasqyrohet se:

*“III. Kandidati i bashkisë Lezhë ka marrë donacion nga personi fizik aksionar në shoqërinë “N.S.S”, shoqëri e cila ka përfituar fonde publike mbi vlerën 10.000.000 lekë (43,739,064 lekë), nëpërmjet një kontrate me AKUK e cila ka shtrirë efektet vetëm gjatë vitit 2021. Kjo është shkelje e nenit 92/1, pika 3 e KZ”.*

*Nga verifikimet e bëra si dhe bazuar në tabelën bashkëlidhur rezulton se shoqëria “N.S.S (Ndreu Security Services)” ka përfituar fonde publike në vlerën mbi 10 milion lekë”.*

11.1. K.Zgjedhor, në nenin 92/1, pika 3, shkronja “a” parashikon se “3. Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme: a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 3 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë. Ky ndalim zbatohet edhe në rastin e nënkontraktimeve apo të kontratave të partneritetit publik privat”.

11.2. Duke qenë se kandidati për kryetar të Bashkisë Lezhë ka përfituar fonde në llogarinë e tij të posaçme bankare nga ortaku i shoqërisë “N. S.S (Ndreu security services)” sh.p.k., me NIPT J68319509H, shoqëri kjo që rezulton se ka përfituar fonde publike mbi vlerën 10 milionë lekë nëpërmjet një kontrate publike gjatë periudhës brenda 3 viteve nga financimi i fushatës elektorale, atëherë jemi në kushtet e ndalimit sipas nenit 92/1, pika 3 shkronja “a” të K.Zgjedhor. Duke qenë se jemi në kushtet e këtij ndalimi, në lidhje me sanksionin për këtë shkelje do i referohemi nenit 173, pika 6 të K.Zgjedhor që parashikon se “Pranimi i fondeve nga donatorë të ndaluar, siç specifikohet në pikën 3, të nenit 92/1, dënohet me kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së dhe me një gjobë të barabartë me dyfishin e shumës së fondeve të marra”.

11.3. Për sa më sipër, KAS vlerëson se duhet të pranohet kërkesa e KShZ për vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën 720 000 lekë për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Lezhë, të Partisë Socialiste, z. Pjerin Ndreu për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

12. Në lidhje me nenin 173, pika 8 të K.Zgjedhor, KShZ, ka propozuar vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë për 5 subjekte zgjedhore<sup>12</sup> për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Neni 173, pika 8 e K.Zgjedhor parashikon se “Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6, të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja nga 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë”. Ndërkohë neni 92/6, pika 6 i K.Zgjedhor parashikon se “KQZ-ja ka të drejtën të verifikojë drejtpërdrejt të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, raportin e auditimit sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe çdo informacion tjetër për lëndën për të cilin vihet në

<sup>12</sup> “Partia Socialiste e Shqipërisë”, “Partia Demokratike”, “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, “Partia Republikane” dhe “Partia Konservatore”.



dijeni. KQZ-ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t'i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohen administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji”.

12.1. KAS vlerëson se për subjektet zgjedhore “Partia Socialiste e Shqipërisë”, “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”, “Partia Republikane” dhe “Partia Konservatore”, duhet të pranohet kërkesa e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në zbatim të nenit 173, pika 8 të K.Zgjedhor, pasi në raste specifike këto subjekte nuk i janë përgjigjur në kohë kërkesave të KQZ-së siç parashikohet në nenin 92/6, pika 6 të K.Zgjedhor. Një sjellje e tillë nga subjektet zgjedhore ka sjellë vonesa për procedurën e auditimit, ndaj është me vend që kjo sjellje të sanksionohet. Megjithatë, referuar intervalit të parashikuar në nenin 173, pika 8 të K.Zgjedhor, në lidhje me vlerën e gjobës për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, KAS vlerëson se edhe në zbatim të neneve 10 dhe 18 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (dispozita të detajuara më sipër), kërkesa e KShZ duhet pranuar pjesërisht duke qenë se në morinë e shumë shkëmbimeve informacioni, ky subjekt zgjedhor ka dështuar vetëm një herë të vetme për t’ju përgjigjur në kohë KQZ-së, ndaj dënimi me gjobë duhet të vendoset në masën 100 000 lekë.

12.2. Gjithashtu KAS vlerëson se kërkesa e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në zbatim të nenit 173 pika 8 e K.Zgjedhor për subjektin zgjedhor “Partia Demokratike” duhet të rrëzohet, pasi gjatë shqyrtimit administrativ rezultoi se kërkesa e KQZ-së për informacion nuk ishte dërguar në adresën e deklaruar nga ky subjekt zgjedhor në zbatim të nenit 64, pika 2, shkronja “c”<sup>13</sup> për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, por në një adresë tjetër, ndaj në këto kushte nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi administrative ky subjekt zgjedhor për aq kohë sa KShZ nuk arriti të provojë dijeninë e këtij subjekti për kërkesën që i është drejtuar nga KQZ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

### **VENDOSI:**

1. Pranimin e pjesshëm të Kërkesës nr. 3, datë 15.11.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
2. Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor për partitë:
  - i. “Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”;
  - ii. “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”;
  - iii. “Partia Aleanca Liberale e Djathtë”;
  - iv. “Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”;
  - v. “Partia Aleanca Progresiste LZHK”;
  - vi. “Partia Ardhmërija Shqiptare”;
  - vii. “Partia Bindja Demokratike”;
  - viii. “Partia Fronti i Majtë”;

<sup>13</sup> Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë.

- ix. “Partia Fryma e Re Demokratike”;
- x. “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”
- xi. “Partia Nisma Thurje” ;
- xii. “Partia Agrare Ambjentaliste”;
- xiii. “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë”;
- xiv. “Partia Balli Kombëtar”;
- xv. “Partia Demokracia Sociale”;
- xvi. “Partia Demokratike”;
- xvii. “Partia e Gjelbër”;
- xviii. “Partia Emigracioni Shqiptar”;
- xix. “Partia Kombëtare Konservatore Albania”;
- xx. “Partia Kristian Demokrate”;
- xxi. “Partia Republikane Shqiptare”;

3. Vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë në vlerën 2 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor për partitë:

- i. “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”;
- ii. “Partia Komuniste e Shqipërisë”;
- iii. “Partia Uniteti Kombëtar”;
- iv. “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”;
- v. “Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare”;
- vi. “Partia Konservatore”;
- vii. “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”;
- viii. “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”.
- ix. “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”;
- x. “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare

4. Kthimin e kërkesës pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për hetim të mëtejshëm administrativ për kandidatët për kryetar bashkie:

- i. Bashkia Belsh, propozuar nga Partisë Socialiste, z. Arif Tafani;
- ii. Bashkia Fier, propozuar nga Partisë Socialiste, z. Armando Subashi;
- iii. Bashkia Durrës, propozuar nga Partisë Socialiste, zj. Emirjana Sako;
- iv. Bashkia Kuçovë, propozuar nga Partisë Socialiste, z. Kreshnik Hajdari;
- v. Bashkia Roskovec, propozuar nga Partisë Socialiste, zj. Majlinda Bufi;
- vi. Bashkia Librazhd, propozuar nga Partisë Socialiste, z. Mariglen Disha;
- vii. Bashkia Mat, propozuar nga Partisë Socialiste, z. Agron Malaj;
- viii. Bashkia Peqin, propozuar nga Partisë Socialiste, z. Bukurosh Maci;
- ix. Bashkia Krujë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Agron Loka;
- x. Bashkia Miriditë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Albert Mëlyshi;
- xi. Bashkia Sarandë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Ardit Cikuli;
- xii. Bashkia Kamëz, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Arjan Hoxha;
- xiii. Bashkia Divjakë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Aurel Malko;
- xiv. Bashkia Shkodër, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Bardh Spahia;
- xv. Bashkia Klos, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Bedri Hoxha;
- xvi. Bashkia Kurbin, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Behar Haxhiu;
- xvii. Bashkia Tropojë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Besnik Dushaj;
- xviii. Bashkia Bulqizë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Dëfrim Fiku;
- xix. Bashkia Gjirokastër, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Dorjan Lani;
- xx. Bashkia Përmet, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Edmond Komino;



- xxi. Bashkia Devoll, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Elvis Hajdërlli;
- xxii. Bashkia Kolonjë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Et' Hem Lumani;
- xxiii. Bashkia Fier, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Evdar Kodheli;
- xxiv. Bashkia Konispol, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Fatmir Shero;
- xxv. Bashkia Kavajë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Fisnik Qosja;
- xxvi. Bashkia Gramsh, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Hasim Çekrezi;
- xxvii. Bashkia Fushë Arrëz, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Hil Curri;
- xxviii. Bashkia Vlorë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Hysni Sharra;
- xxix. Bashkia Durrës, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Igli Cara;
- xxx. Bashkia Dibër, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Ismail Uka;
- xxxi. Bashkia Kuçovë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Lefter Maliqi;
- xxxii. Bashkia Elbasan, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Luçiano Boçi;
- xxxiii. Bashkia Has, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Miftar Dauti;
- xxxiv. Bashkia Lezhë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Pashk Gjoni;
- xxxv. Bashkia Mallakastër, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Resmi Shanaj;
- xxxvi. Bashkia Librazhd, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Shefki Cota;
- xxxvii. Bashkia Rrogozhinë, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Shkëlqim Hoxha;
- xxxviii. Bashkia Patos, propozuar nga Partia e Lirisë, zj. Sofije Alushaj;
- xxxix. Bashkia Berat, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Zija Ismaili;
- xl. Bashkia Pogradec, propozuar nga Partia e Lirisë, z. Zini Tollozhina.

5. Vendosjen e sanksionit administrativ për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Lezhë, të Partisë Socialiste, z. Pjerin Ndreu me gjobë në vlerën 720 000 lekë, sipas nenit 173, pika 6 të Kodit Zgjedhor.

6. Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë gjobë në vlerën 100 000 lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor për:

- i. “Partia Socialiste e Shqipërisë”;
- ii. “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”;
- iii. “Partia Republikane”;
- iv. “Partia Konservatore”.

7. Rrëzimin e kërkesës për marrjen e sanksionit administrativ ndaj:

- i. “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- ii. “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- iii. “Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- iv. “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- v. “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- vi. “Partia e Komuniste e Shqipërisë”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- vii. “Partia Konservatore”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- viii. “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- ix. “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- x. “Partia Uniteti Kombëtar”, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;
- xi. “Partia Demokratike”, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative“, të ndryshuar” mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

Njoftuar palëve të pranishme me shpalljen.

U shpall sot më datë 05.12.2024

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilijan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>